



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 218/4 Prot

Tiranë, më 06. 4 .2016

URDHËR

Nr. 09 datë 06/4 2016

Mbështetu: në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr.52/2014, "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; dhe Nr.106/2014, "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetimit Administrativ në ngarkim të kontrolluesit klinika mjekësore "Dermo Life" person fizik, Tiranë,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.39, datë 22.02.2016 të Komisionerit, pranë kontrolluesit klinika mjekësore "Dermo Life" p.f., Tiranë, është zhvilluar hetim administrativ me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika mjekësore "Dermo Life" p.f., i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit vëren se:

Klinika mjekësore "DermoLife" p.f., ofron shërbime shëndetësore estetike. Gjatë aktivitetit të tij ky subjekt mbledh, përpunon, ruan etj., të dhëna personale të punonjësve dhe subjekteve të të dhënave "pacientë". Në kuptim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ky subjekt është në kushtet e Kontrolluesit.

Grupi i hetimit konstatoi se, gjatë ushtrimit të aktivitetit të kontrolluesit klinika mjekësore "DermoLife" p.f., ndër format e ndryshme të grumbullimit të të dhënave (manuale dhe elektronike), ai percepton imazhe nga një sistem video-vëzhgimi CCTV, nëpërmjet të cilit

mbikëqyr ambientet e brendshme duke përfshirë edhe dhomat e masazhit apo të ndërhyrjeve intime estetike.

Në përfundim të hetimit administrativ pasi u mbajt procesverbali për konstatimet e gjetura nga ana e grupit të hetimit, përfaqësuesja e kontrolluesit parashitroi pretendimin: *"Nuk kam pasur dijeni për ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale megjithatë ne do të rikuperojmë sa më shpejtë të jetë e mundur shkeljet e konstatuara"*.

Konstatimet e gjetura konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10/03/2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, por mbikëqyrja në ambientet ku kryhet masazhi dhe ambientet e ndërhyrjeve intime estetike, përbën një shkelje flagrante dhe serioze.

Pavarësisht faktit se kontrolluesi i ka marrë masat duke hequr kamerat vëzhguese nga këto ambiente, kjo masë mbetet e pamjaftueshme.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit veç akteve të tjera ligjore që do ndër marrë rekomandim apo vendim, në funksion të shkeljeve të tjera sipas rastit, reagon me përparësi dhe në mënyrë të menjëhershme me këtë urdhër, në lidhje me shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale të siguruar në mënyrë të paligjshme nga mbikëqyrja në ambientet ku kryhet masazhi apo dhe në ambientet e ndërhyrjeve intime estetike.

Neni 30, paragrafi 1, gërma "b" e ligjit të sipërcituar përcakton se: *"Komisioneri ka këto të drejta: b) ardhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale"*.

**Sa më sipër:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 27, 28, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

#### **URDHËROJ:**

1. Kontrolluesi, klinika mjekësore *"Dermo Life" p.f.*, të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale të siguruar në mënyrë jo të drejtë dhe haptazi të paligjshme, nëpërmjet sistemit video-vëzhgimi CCTV, i cili mbikëqyr ambientet e brendshme, si dhomat e masazhit apo të ndërhyrjeve intime estetike.
2. Kontrolluesi, klinika mjekësore *"Dermo Life" p.f.*, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij urdhëri, të ketë realizuar shkatërrimin e të dhënave sipas pikës 1.
3. Kontrolluesi, klinika mjekësore *"Dermo Life" p.f.*, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër.
4. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*; i ndryshuar.

Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më 06.4 2016

Besnik DERYSHI  
  
KOMISIONERI